



Drejtoria e Arsimit
Dt. 18.05.2022
S U H A R E K Ë

U realizua testimi “ PISA 2022” në komunën e Suharekës

Bazuar në kërkesat e MASHTI-t, Drejtoria e Arsimit ka bërë gjitha përgatitjet për realizimin e projektit “ PISA 2022” ku nga komuna jaonë janë përzgjedhur dhjetë shkolla: tri shkollat e mesme të larta : gjimnazi ” Jeta e re “, shkolla profesionale” Abdyl Ramaj”- Shirokë dhe shkolla teknike “ Skender Luarasi ” dhe shtatë shkolla të mesme të ulta: “ Sadri Duhla”-Duhël, “ Kongresi i Manastirit”- Studenqan,”Bajram Curri”-Nishor, “Dëshmorët e Tivarit”-Peqan, “ V.P.Shkodrani”- Leshan, “ Edit Durham “ Mushtisht dhe “ Naum Veqilharxhi”-Mohlan

Udhëheqësit e projektit “PISA 2022” kanë pranuar nga ne informacionet e sakta për të gjithë nxënësit në të gjitha shkollat që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë. Kriteret për pranueshmërinë e nxënësve PISA kanë qenë: nxënësit e lindur nga 01.01.2005 dhe 31.12.2005.

Nga gjithsejt 15 vjeçarët e komunës sonë 192 nxënës janë përzgjedhur për t’iu nënshtruar këtij testii cili u realizua sipas datave në vijim :

-me date 16.05.2022 testit iu nënshtruan nxënësit e gjimnazit ‘ Jeta e re’,” Sadri Duhlës”, Bajram Currit” dhe “ Dëshmorët e Tivarit ;

-me date 17.05.2022 testit iu nënshtruan nxënësit e shkollës “ Kongresi i Manastirit”, “ Abdyl Ramaj” dhe “ V.P.Shkodrani;

-me date 18.05.2022 testit iu nënshtruan nxënësit e shkollës “ Skender Luarasi”, “ Edit Durham”, dhe “ Naum Veqilharxhi”

Poashtu në këtë process janë përfshirë edhe mësimmhënësit e fushave të caktuara dhe drejtorët e shkollave .

Pyetësori i drejtorit dhe mësimmhënësve kanë siguruar informacione që vërtetojnë përgjigjet, ku kanë dhënë informacione kryesore mbi mësimin në klasë dhe kanë pasqyruar prejardhjen arsimore të mësimmhënësve, trajnimet dhe përvojat e tyre. Pyetësorët janë plotësuar në internet duke përdorur një procedurë të sigurt për hyrje.

Në të gjitha shkollat pjesëmarrëse në testim janë caktuar koordinatorët e shkollave te cilët kanë punuar me nxënësit në parapërgatitjet për testim ndërsa Drejtoria e Arsimit ka ndihmuar në këtë process në takimet e shpeshta me koordinatorët e shkollave, pranimin dhe dorëzimin e udhëzimeve mbi Pyetësorin e shkollës dhe pyetësorin e mësimmhënësit së bashku me material të tjera informuese, te caktuara nga DVSM.

Drejtori i Drejtorisë komunale të arsimit Z.Rmzi Bajselmani u ka uruar suksese në punë dhe rezultate në këtë testim

Suharekë,
18.05.2022

DKA-Suharekë



